

Statistika të Diplomimeve


2017-2018

Tiranë, më 15 Maj 2019: Në vitin 2018, në arsimin 9 - vjeçar u diplomuan 37.795 nxënës, ose 95,4 % e nxënësve të klasës së nëntë të vitit shkollor 2017 - 2018, duke shënuar një rënie prej 1 pikë përqindje, krahasuar me vitin paraardhës. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 51,1 % djem dhe 48,9 % vajza.

Në vitin 2018, në arsimin e mesëm u diplomuan 35.278 nxënës, me një rënie prej 3,2 %, krahasuar me 2017. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 48,6 % djem dhe 51,4 % vajza.

Raporti bruto i diplomimit (numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program) për arsimin e mesëm është 78,3 %.

Fig. 1 Shkalla e diplomimit në arsimin e mesëm




Të Diplomuar në arsimin e lartë

Në vitin 2018 janë diplomuar në arsimin e lartë 34.331 studentë, ose 3,0 % më pak se në vitin 2017. Ndër të diplomuarit e këtij viti, 63,3 % janë gra dhe 36,7 % janë burra. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 58,6 % të studentëve të diplomuar gjithsej.


Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentët në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 28,4 %.

Fig. 2 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit, 2018



Në vitin 2018, gratë dhe burrat e diplomuar sipas fushave të studimit, mbajnë përqindje të ndryshme ndër të diplomuarit gjithsej. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë gratë janë “Shëndet dhe mirëqenie” me 78,9 %, ndjekur nga “Arsim” me 77,7 % dhe “Shkenca sociale, gazetari dhe informacion” me 74,2 %. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë burrat janë “Shërbime” me 71,1 %, “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 61,7 %, dhe “Teknologji e Informacionit dhe komunikimit” me 56,3 %.

Fig. 3 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2018



Metodologjia

Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit :

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime:

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si: kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimit bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimit fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimit i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimit 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë, si edhe atë social – kulturor. Ky i fundit paraqitet në statistika bashkë me arsimin profesional.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të dizajnuara me qëllime përfitim të njohurive, shkathtësitë dhe kompetencat specifike për një profesion të veçantë, klasë të profesioneve ose tregti.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Raporti bruto i diplomimit është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program.

Burimi i të dhënave të diplomimeve : MASR